Ardian Maçi ka lindur më 26 shkurt 1963 në Tiranë. Ai është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë, dega Financë, në vitin 1986.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 1986 si shef llogarie në Kantierin e Ndërtimit të Urave në hekurudhën Milot–Rrëshen–Klos, detyrë që e ka ushtruar deri në shkurt të vitit 1992. Nga viti 1992 dhe për një periudhë 12-vjeçare, ka punuar pranë Administratës Doganore, ku ka mbajtur funksione të ndryshme profesionale dhe drejtuese, përfshirë pozicionet e specialistit, Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në vitet 1998–1999.

Ndër të tjera, ka vijuar angazhimin e tij profesional si Drejtor Ekzekutiv në Ndërmarrjen e Prodhimeve Farmaceutike "Profarma" sh.a. Përgjatë viteve 2007–2010 ka ushtruar detyrën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm në kompaninë "Supersport" sh.a., pjesë e platformës DigitAlb, ndërsa më pas ka qenë Administrator i gazetës javore "Free Press".

Në periudhën 2014–2018, Ardian Maçi ka ushtruar fillimisht detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe më pas atë të Drejtorit të Përgjithshëm të Tregut të Brendshëm dhe Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Aktualisht, ushtron detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, pozicion të cilin e ka mbajtur më herët edhe pranë Ministrisë së Brendshme.

Gjatë karrierës së tij profesionale, ka ndjekur trajnime dhe specializime të shumta në fushën ekonomike, financiare dhe menaxheriale, ndër të cilat përfshihen specializimi në Shkollën Kombëtare të Doganave Franceze (Écoles Nationales des Douanes) në Paris, si dhe trajnimet për sistemin ASYCUDA++ pranë UNCTAD në Gjenevë. Gjithashtu, ka qenë bashkëpunëtor me CAM Albania në procesin e hartimit të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe konsulent në përgatitjen e botimit "Historiku i Doganave Shqiptare".